

VENDIM
Nr. 330, datë 28.5.2014

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR 5
PRIORITETET E REKOMANDUARA NGA
KOMISIONI EVROPIAN, 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integritimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian (më poshtë udhërrëfyesi), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integritimit Evropian është përgjegjëse për bashkërendimin dhe monitorimin e zbatimit të udhërrëfyesit dhe raporton në Këshillin e Ministrave dhe Komitetin Ndërmintor për Integritimin Evropian për ecurinë e procesit.

3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore raportojnë çdo javë pranë Ministrisë së Integritimit Evropian për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga udhërrëfyesi.

4. Vendimi nr. 988, datë 8.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit të Veprimit për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, për të cilat në udhërrëfyes përcaktohen detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËRRËFYES
MBI 5 PRIORITETET

(KY UDHËRRËFYES DO TË BASHKOHET NË 2015
DHE DO TË PËRSHTATET ME PËRPARIMIN E
BËRË NË ÇDO FUSHË)

Hyrje

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një nga pikësynimet strategjike dhe objektivi kombëtar për Republikën e Shqipërisë. Qeveria është plotësisht e ndërgjegjshme që për arritjen e këtij objektivi nevojitet angazhim maksimal dhe përpjekje të vazhdueshme në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare. Në këtë rrugë, marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian përbëjnë prioritetin kryesor të qeverisë.

Në tetor 2013, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit në të cilin reflektohen të gjitha zhvillimet dhe progresi në harkun kohor të një viti. Gjithashtu, Raporti i Progresit identifikon ndërhyrjet e nevojshme dhe jep rekomandimet përkatëse. Strategjia e Zgjerimit 2013-2014 përcakton 5 prioritetet kyçe si parakusht për fillimin e negociatave të anëtarësimin, të cilat janë:

1. Të vijohet zbatimi i reformës në administratën publike, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimin e administratës publike;

2. Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore;

3. Të merren masa të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshi krijimin e një vijimësie rezultatesh konkrete (*track record*) me hetime kryesisht, procedime penale dhe dënime;

4. Të merren masa të vendosura në luftën kundër krimit të organizuar, përfshi krijimin e një historiku solid (*track record*) me hetime kryesisht, procedime penale dhe dënime;

5. Të merren masa efektive për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi mbrojtjen e romëve dhe politikant antidiskriminim, si edhe të zbatohen të drejtat e pronësisë.

Në adresim të këtyre kritereve dhe në kuadër të nismës së Dialogut të Nivelit të Lartë (DNL) për Prioritetet Kyçe ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian¹ u mor angazhim për përgatitjen e një “Udhërrëfyesi” për zbatimin e reformave të nevojshme për 5 prioritetet kyçe për procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

Për këtë qëllim Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe institucionet shqiptare të përfshira inicioi një proces gjithëpërfshirës dhe analizes për të identifikuar dhe përcaktuar një set masash me hapa dhe përgjegjësi të qarta për çdo institucion përgjegjës. “Udhërrëfyesi” u hartua sipas një udhëzuesi të hartuar nga MIE, i shpërndarë për të gjitha grupet e punës. Grupet e punës të ngritura për çdo prioritet, kanë organizuar takime konsultative me të gjitha institucionet pjesëmarrëse, përfshirë institucionet e pavarura, si Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Objektivat dhe masat e planifikuara për zbatim sipas secilit nga 5 prioritetet kyçe janë:

Në lidhje me **reformën në administratën publike**, një nga objektivat kryesorë është zbatimi i ligjit “Për nëpunësin civil”, ku hapi i parë është miratimi i akteve

¹ Takimi i parë i DNL u zhvillua në Tiranë më 12 nëntor 2013.

nënligjore të nevojshme. Një tjetër zhvillim në kuadrin ligjor është miratimi i ligjit "Kodi i Procedurave Administrative", si edhe i akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore". Masa do të merren për të përmirësuar procedurën e rekrutimit, emërimit dhe ngritjes në detyrë në shërbimin civil, si edhe për të shtrirë më tej sistemin HRMIS (sistemi informatik për menaxhimin e burimeve njerëzore). Në fokusin e kësaj reforme është edhe funksionimi i duhur i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), pajisja e saj me mjetet e nevojshme dhe burimet njerëzore si edhe planifikimi i përshtatshëm. Një tjetër objektivi i reformës është forcimi i kapaciteteve administrative dhe koordinimit të Departamentit të Administratës Publike, i nevojshëm për zbatimin e ligjit të ri për shërbimin civil.

Në lidhje me **reformën në gjyqësor**, qeveria është plotësisht e angazhuar që të zbatojë reformat për konsolidimin e shtetit të së drejtës, bazuar në sugjerimet dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, si edhe në bashkëpunimin me institucione të tjera shtetërore.

Në këtë drejtim, jemi të angazhuar me Komisionin e Venecias për një sërë reformash që synojnë forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor. Një nga objektivat është edhe përmirësimi i sistemit të emërimit, vlerësimit, ngritjes në detyrë dhe transferimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjë që kërkon miratimin e disa ndryshimeve ligjore. Do të merren masa për të reduktuar numrin e çështjeve gjyqësore të akumuluar, si përmes ndryshimeve ligjore, ashtu edhe përmirësimeve në infrastrukturë dhe burime. Në fokus është edhe reforma në sistemin e inspektiveve, në mënyrë që t'iu jepen më shumë kompetenca inspektorëve. Prioritet është funksionimi i plotë i gjykatave administrative, me një sërë masash të parashikuara për këtë qëllim, përkrah masave për forcimin e luftës kundër korrupsionit në gjyqësor.

Në kuadrin e **reformave antikorrupsion**, gjatë tremujorit të fundit 2013, janë marrë një sërë masash konkrete për të garantuar vullnetin e fuqishëm politik të Qeverisë për zgjidhjen e fenomenit të korrupsionit në vend. Gjatë kësaj periudhe është ngritur Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion (KKAK)², si një organ i rëndësishëm në nivel ministrie që koordinon përpjekjet dhe politikant antikorrupsion në nivel kombëtar. Paralelisht me ngritjen e KKAK-së, dy procese të rëndësishme filluan: a) hartimi i Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion 2014 -2017; dhe b) krijimi i rrjetit të koordinatorëve dhe pikave fokale antikorrupsion, si në institucionet e pavarura ashtu edhe në ato të nivelit ekzekutiv (përfshi nivelin vendor). Në lidhje me statistikat e harmonizuara dhe historikun solid për çështjet e korrupsionit, grupet e punës të kryesuara nga

Ministri i Drejtësisë kanë përgatitur të dhënat për tremujorin e tretë të 2013. Gjatë vitit 2014, puna do të fokusohet në ngritjen e një databaze elektronike që mundëson analiza të thelluara mbi bazën e statistikave dhe të dhënave të gjeneruara në çdo tremujor. Procesi do të udhëhiqet nga KKAK.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë. Shqipëria është e përkushtuar që të përforsojë rezultatet pozitive të arritura, si dhe të adresojë rekomandimet e progresraportit 2013 të KE-së për Shqipërinë. Rezultatet e viteve të fundit tregojnë progresin e bërë në lidhje me bashkëpunimin policor dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese për të garantuar imponim të ligjit është një prioritet i mishëruar në këtë plan veprimi. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimi ndërkombëtar policor vazhduan të japin rezultate të mira, për as i përket operacioneve, arrestimeve dhe hetimeve të përbashkëta, përfshi këtu hetimet e pasurive kriminale. Përpjekjet antitrafik në nivel kombëtar koordinohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, ku angazhohen jo vetëm organet shtetërore, por edhe institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe publiku i gjerë.

Në fushën e **të drejtave të njeriut**, objektivat janë përkthyer në masa dhe hapa konkretë dhe përfshijnë: Zbatimin efikas dhe ndërgjegjësimit mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi; Miratimin e legjislativës antidiskriminim dhe harmonizimin e dispozitave ekzistuese; Forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke ngritur mekanizmin kontrolli periodik për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), si edhe duke akorduar buxhet të mjaftueshëm për funksionimin e NJMF-ve; Forcimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje; Përmirësimin e koordinimit ndërmjet autoriteteve vendore dhe qendrore, si edhe i mekanizmave monitorues për zbatimin e detyrimeve në kuadrin e Dekadës Rome, si edhe i rekomandimeve operacionale dhe Planin e Masave në vijim të Seminarit për Përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane; Zbatimin efektiv i kuadrin ligjor për të drejtat ekonomike dhe sociale, sidomos për personat me aftësi të kufizuara, si edhe i politikave dhe masave për respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve.

Në lidhje me monitorimin dhe raportimin, është propozuar që zbatimi i Udhërrëfyesit të ndiqet nëpërmjet Dialogut të Nivelit të Lartë. Gjithashtu, raportime do bëhen edhe në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit. Raporte shtesë mund të dorëzohen me kërkesë të Komisionit Evropian.

² Në bazë të VKM nr. 1012, datë 22/11/2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Çështjet Vendore".

Prioriteti 1:**Të vijohet zbatimi i reformës në administratës publike me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimin e administratës publike**

1. Reforma ligjore			
Nr.	Masat/aktivitetet e planifikuara	Institucionet përgjegjëse	Afatet
1.1	<p>Zbatimi i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe legjislacionit dytësor – Miratimi i akteve nënligjore në zbatim.</p> <p>1.1.1 Dërgimi dhe marrja e mendimit zyrtar nga palët e interesuara;</p> <p>1.1.2 Dërgimi për miratim në Këshillin e Ministrave;</p> <p>1.1.3 Kryerja e trajnimeve intensive dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere për të gjitha institucionet e përfshira në këtë ligj (dhe me mbështetjen e SIGMA-s);</p> <p>1.1.4 Krijimi i një mekanizmi monitorimi për zbatimin e ligjit, përmes të cilit të sigurohet raportim periodik, sidomos në lidhje me rekrutimet dhe largimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e një mekanizmi për raportim të dhënash <i>online</i> për të gjitha institucionet e administratës publike, në kuadrin e ligjit të ri për shërbimin civil; - Kryerja e inspektimeve çdo dy muaj për zbatimin e ligjit të ri për shërbimin civil, si edhe rezultatet të raportohen te Kryeministri; - Gjenerimi i raporteve të monitorimit nga HRMIS (sapo të bëhet funksional). <p>1.1.5 Ndryshimi dhe harmonizimi i të gjitha ligjeve relevante me ligjin e ri për shërbimin civil, duke realizuar këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i të gjitha ligjeve relevante që do të 	<p>MIAP, DAP, KM, ministritë e linjës, institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, njësitë e qeverisjes vendore</p> <p>MIAP, DAP, të gjitha institucionet e administratës shtetërore</p> <p>MIAP, DAP</p> <p>MIAP, DAP</p> <p>MIAP, DAP, ministritë e linjës</p>	<p>Janar 2014</p> <p>Shkurt 2014</p> <p>Mars 2014 dhe në vazhdim</p> <p>Prill 2014 dhe në vazhdim</p> <p>Maj 2014 dhe në vazhdim</p> <p>Në vazhdim</p> <p>Në vazhdim</p>

	<p>ndryshohen dhe harmonizohen me ligji e ri për shërbimin civil;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e projektndryshimeve për ligjet relevante që do të harmonizohen me ligjin e ri për shërbimin civil; - Dërgimi dhe marrja e opinionëve zyrtare nga ministritë e linjës; - Shqyrtimi dhe dërgimi i të gjitha projektndryshimeve pranë KM-së për miratim. 	<p>Ministritë e linjës, MIAP, DAP</p> <p>Ministritë e linjës</p> <p>Ministritë e linjës, KM</p>	<p>Prill 2014</p> <p>Korrik 2014</p> <p>Gusht 2014</p> <p>Shtator 2014</p>
<p>1.2</p>	<p>Miratimi i ligjit “ Kodi i Procedurave Administrative” për procedurën e përgjithshme administrative (Përgatitjet për zbatimin gradual të ligjit dhe krijimi i indikatorëve të matshëm të progresit)</p> <p>1.2.1 Prezantimi i projektligjit nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë, si edhe konsultimi i tij me akademikët e të drejtës administrative.</p> <p>1.2.2 Organizimi i takimeve konsultative me teknikienë / profesionistë që merren me zbatimin e ligjit “Kodi i Procedurave Administrative”.</p> <p>1.2.3 Pasqyrimi në projektligj i komenteve e sugjerimeve të dala nga këto konsultime.</p> <p>1.2.4 Dorëzimi i projektligjit për miratim pranë Këshillit të Ministrave.</p> <p>1.2.5 Përgatitjet për zbatimin normal të ligjit “Kodi i Procedurave Administrative” (me asistencën e projektit të IPA 2012 “Mbështetje për reformën në shërbimin</p>	<p>MD, MSHIAP + DAP (për komponentin e “ Kodi i Procedurave Administrative”, që i përket projektit IPA 2012)</p>	<p>18/02/2014</p> <p>19/02/2014</p> <p>01/04/14</p> <p>08/05/201</p> <p>Brenda 1 viti nga data e miratimit të draftit</p>

	<p>civil”, duke realizuar këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimi i legjislacionit administrativ dhe vlerësimi i përputhshmërisë së tij me nevojat e ligjit të ri, si edhe asistimi në hartimin e akteve nënligjore, nëse nevojitet. Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve mbi kuadrin e ri ligjo; - Përgatitja e një manuali apo komentari për dispozitat e ligjit të ri, ku të jepen shpjegime të hollësishme praktike. 		
1.3	<p>Zbatimi i ligjit “<i>Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore</i>”, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji</p> <p>1.3.1 Ngritja e grupit ndërinstitucional të punës;</p> <p>1.3.2 Takimi i parë i grupit të punës;</p> <p>1.3.3 Përgatitja e draftit të parë të akteve nënligjore;</p> <p>1.3.4 Pasqyrimi i sugjerimeve dhe komenteve të bëra;</p> <p>1.3.5 Dërgimi dhe marrja e opinionëve zyrtare të palëve të interesuara;</p> <p>1.3.6 Dorëzimi për miratim pranë Këshillit të Ministrave;</p> <p>1.3.7 Ndryshimi dhe harmonizimi me këtë ligj i të gjithë legjislacionit ekzistues për organizimin dhe funksionimin e çdo institucioni në varësi të Qeverisë dhe Ministrive, duke realizuar këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i të gjithë legjislacionit që ka nevojë për ndryshime dhe harmonizim; - Përgatitja e projektndryshimeve përkatëse që garantojnë harmonizimin me ligjin; 	<p>MIAP, DAP, KM, ministritë e linjës,</p> <p>Agjencitë e pavarura, institucionet e administratës shtetërore</p> <p>MIAP, DAP, ministritë e linjës</p> <p>Ministritë e linjës, MIAP, DAP</p>	<p>5 shkurt 12 shkurt 30 prill 15 maj</p> <p>30 qershor 30 korrik 2014</p> <p>Mars 2014</p> <p>Maj 2014</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Dërgimi dhe marrja e opinionit zyrtar nga ministrinë e linjës; - Shqyrtimi dhe dorëzimi i të gjitha projektndryshimeve pranë KM-së për miratim. 	<p>Ministrinë e linjës</p> <p>Ministrinë e linjës, KM</p>	<p>Qershor 2014</p> <p>Korrik 2014</p>
1.4	<p>Garantimi i zbatimit të ligjit për Gjykatën Administrative:</p> <p>1.4.1 Garantimi i funksionimit të gjykatave administrative.</p> <p>1.4.2 Plotësimi i vendeve vakante me gjyqtarë në gjykatat administrative të shkallës së parë në Gjirokastrë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, sipas dekretit të Presidentit nr. 7818/2012 (testimi selektiv).</p> <p>1.4.3 Plotësimi i strukturës organizative të gjykatave administrative me numrin e nevojshëm të punonjësve në administratën gjyqësore, përfshi asistentët ligjorë (hartimi dhe miratimi i Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë).</p> <p>1.4.4 Përmirësimi i infrastrukturës së gjykatave administrative.</p> <p>1.4.5 Trajnimi i personelit të gjykatave administrative (gjyqtarët dhe administrata gjyqësore).</p>	<p>MD, ZABGJ, KLD, Shkolla e Magjistraturës dhe Gjykatat Administrative</p> <p>Këshilli i Lartë i Drejtësisë</p> <p>MD, ZABGJ</p> <p>MD, ZABGJ, gjykatat administrative Shkolla e Magjistraturës, MD, gjykatat administrative</p>	<p>2014 dhe në vazhdimësi</p> <p>Brenda qershorit 2014</p> <p>2014</p> <p>2014 dhe në vazhdimësi</p> <p>Në vazhdimësi</p>
2. Përmirësimi i procedurës së rekrutimit, emërimit dhe ngritjes në detyrë në shërbimin civil			
Nr.	Masat/aktivitetet e planifikuara	Institucionet përgjegjëse	Afatet
2.1	<p>2.1.1 Zbatimi i legjislacionit të ri për shërbimin civil (DAP do të mbështetet në këtë proces nga projekti IPA 2012 “Mbështetje për reformën në administratën publike) nëpërmjet:</p> <p>2.1.2 Përmirësimi të metodave aktuale të testimit duke zhvilluar rekrutimet në grup;</p> <p>2.1.3 Ngritjes së një komisioni përzgjedhës permanent,</p>	<p>MIAP, DAP, ASPA, ministrinë e linjës</p>	<p>Prill 2014 dhe në</p>

	<p>transparent dhe të paanshëm;</p> <p>2.1.4 Krijimit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues të Shërbimit Civil (TND);</p> <p>2.1.5 Zhvillimit të karrierës dhe ngritjen në detyrë;</p> <p>2.1.6 Përmirësimit të natyrës së konkurseve;</p> <p>2.1.7 Lehtësimit të lëvizshmërisë së nëpunësve civilë në vijimësi.</p>		vazhdim
3. Fuqizimi i mjeteve për një administratë publike efektive			
Nr.	Masat/aktivitetet e planifikuara	Institucionet përgjegjëse	Afatet
3.1	<p>Përmirësimi dhe shtrirja e sistemit informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore (SIMBNJ/HRMIS):</p> <p>3.1.1 Miratimi i projektvendimit “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”;</p> <p>3.1.2 Hedhja e të dhënave nga ministritë e linjës (funksioni i modulit të burimeve njerëzore);</p> <p>3.1.3 Finalizimi i Termave të Referencës për Projektin e Fondit të Besimit HRMIS;</p> <p>3.1.4 Realizimi i tenderimit të projektit SPI/Fondi i Besimit;</p> <p>3.1.5 Fillimi i zbatimit të projektit SPI/Fondi i Besimit, në funksion të zgjerimit të HRMIS dhe lidhjes së tij me sistemin e pagave/thesarit;</p> <p>3.1.6 Vijimin e punës për bërjen plotësisht funksional të HRMIS-it.</p>	<p>MIAP, DAP, KM, ministritë e linjës, institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, njësitë e qeverisjes vendore</p>	<p>Shkurt 2014</p> <p>Fundi i marsit</p> <p>Fundi i marsit 2014</p> <p>Fundi i majit 2014</p> <p>30 shtator 2014</p>

			Fundi i 2014 dhe në vazhdimësi
3.2	Sigurimi i mirëfunksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike ASPA. Pajisja e ASPA-s me mjetet dhe burimet e nevojshme, mbështetje nga buxheti i shtetit, burime njerëzore dhe planifikim i duhur:		
3.2.1	Rikonstruksioni i godinës së ASPA-s dhe kompletimi i mjediseve të trajnimit me pajisjet dhe mjetet e TI për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese;	ASPA, MIAP, Ministria e Financave, MPB për realizimin e tenderimit	30 qershor 2014
3.2.2	Përditësim dhe plotësim i analizës së nevojave për trajnim. Hartimi i një metodologjie për vlerësimin e aftësive dhe hartimi i një raporti vlerësues;	ASPA	31 mars 2014
3.2.3	Hartimi i strategjisë së trajnimit 2014 – 2020, në kuadër të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike;	MIAP (DAP + ASPA)	Qershor 2014
3.2.4	Hartimi i kurrikulës së trajnimit për TND, bazuar në një analizë të nevojave për trajnim të këtij;	ASPA	30 shtator 2014
3.2.5	Përgatitja e planit të trajnimit të vazhduar 2014, duke përcaktuar grupet e synuara, trajnimet e detyrueshme dhe periudhën e zhvillimit;	ASPA	30 janar 2014
3.2.6	Zhvillimi i programeve të trajnimit sipas planit të trajnimit;	ASPA	Në vazhdimësi
3.2.7	Vendosja e marrëdhënieve të partneritetit për realizimin e procesit të certifikimit;		

	3.2.8 Krijimi i sistemit <i>e-learning</i> për trajnimin. Digjitalizimi i materialeve të trajnimit për ASPA.	ASPA MIAP (ASPA + DAP)	Dhjetor 2014 Dhjetor 2014
3.3	<p>Forcimi i kapaciteteve administrative dhe koordinimit me Departamentit të Administratës Publike, në funksion të zbatimit të ligjit të ri për shërbimin civil:</p> <p>3.3.1 Konsultimi dhe miratimi i strukturës së re të DAP-it me qëllim forcimin e burimeve njerëzore;</p> <p>3.3.2 Garantimi i koherencës së legjislacionin që disiplinon autoritetin mbikëqyrës të DAP-it, duke miratuar ndryshimet e nevojshme në ligjin për nëpunësin civil në lidhje me pavarësinë e DAP-it.</p>	<p>MIAP, DAP, KM, Ministria e Financave</p> <p>Këshilli i Ministrave</p>	<p>Mars 2014</p> <p>Fundi i shkurtit 2014</p>
3.4	<p>Rishikimi dhe miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (me asistencën e SIGMA-s):</p> <p>3.4.1 Ngritja e grupeve ndërministrrore dhe ndërinstucionale të punës, përgjegjëse për strategjinë RAP;</p> <p>3.4.2 Analizimi i fushave që duhen shtuar në draftin e Strategjisë, përcaktimi i sferës së veprimit të saj, si edhe konceptimi i një procesi gjithëpërfshirës për hartimin e saj;</p> <p>3.4.3 Diskutimi dhe miratimi i objektivave të strategjisë, si edhe përpilimi i masave dhe aktiviteteve të saj;</p> <p>3.4.4 Përcaktimi i arritjeve dhe zhvillimi i treguesve për matjen e arritjeve;</p> <p>3.4.5 Organizimi i procesit të konsultimit dhe përgatitja e draftit përfundimtar të Strategjisë;</p> <p>3.4.6 Dërgimi i projektstrategjisë për miratim në KM.</p>	MIAP, DAP, KM, ministrinë e linjës	<p>Prill 2014</p> <p>Prill 2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>2014</p> <p>Fundi i 2014-ës</p> <p>Fundi i 2014-ës</p>

4. Forcimi i institucioneve të pavarura mbikëqyrëse të administratës publike			
Nr.	Masat/aktivitetet e planifikuara	Institucionet përgjegjëse	Afatet
4.1	Sigurimi i pavarësisë dhe kapaciteteve administrative të institucioneve të pavarura (Avokati i Popullit, KSHC, KLSH):		
4.1.1	Miratimi i ligjit të ri “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”;		
4.1.2	Garantimi i pavarësisë institucionale në aktet nënligjore që Qeveria pritet të nxjerrë në zbatim të ligjit për shërbimin civil;	Kuvendi i Shqipërisë	1 qershor 2014
4.1.3	Garantimi i pavarësisë ekonomike të KLSH-së; nëpërmjet miratimit të buxhetit vjetor të propozuar nga ky institucion;	Këshilli i Ministrave Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave, Komisioni i Ekonomisë, Kuvendi i Shqipërisë	Brenda 2014 Çdo vit e në vazhdimësi Maj 2014
4.1.4	Forcimi i kapaciteteve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, që do të zëvendësojë KSHC-në, nëpërmjet miratimit të strukturës organizative në zbatim të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 ”Për nëpunësin civil”.	Kuvendi i Shqipërisë	20 mars 2014
4.1.4.1	Dorëzimi i aplikimeve (kandidatët për KMSHC);	Kuvendi i Shqipërisë	20 prill 2014
4.1.4.2	Përzgjedhja e kandidatëve;	Kuvendi i Shqipërisë	Fundi i prillit 2014
4.1.4.3	Propozimi i strukturës, rregullore së brendshme dhe buxhetit;	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	15 maj 2014
4.1.4.4	Miratimi i strukturës, rregullore së brendshme dhe buxhetit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;	Kuvendi i Shqipërisë	
4.1.5	Sigurimi i pavarësisë nëpërmjet miratimit të një buxheti financiar që të përballojë nevojat e institucionit gjatë implementimit të ligjit të ri për shërbimin civil.	Kuvendi i Shqipërisë	Gjatë 2014

Prioriteti 2: Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore

1. Angazhimi me Komisionin e Venecias dhe miratimi i një sërë reformash që synojnë rritjen e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësor			
Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
1.1	Sigurimi i Komisionit të Venecias me një përmbledhje të çështjeve që do të vlerësohen në lidhje me pavarësinë, llogaridhënien dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor dhe sigurimin e bashkëpunimit me këtë organ.	Ministria e Drejtësisë	Është dërguar letra në Komisionin e Venecias në janar 2014
1.2	<p>Angazhimi i mëtejshëm me Komisionin e Venecias, mbi bazën e konstatimeve të këtij të fundit, në mënyrë që të finalizohet një paketë e plotë e reformës dhe marrjen e të gjitha masave për miratimin e saj përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultativ.</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka rënë dakord me Komisionin e Venecias që t'i dërgojë zyrtarisht projektligjet për këtë qëllim (ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile, që synojnë kufizimin e kompetencave të Gjykatës së Lartë për çështjet penale, si edhe parashikojnë sanksione ndaj avokatëve në rast mungese në seanca gjyqësore). Komisioni i Venecias do të na japë mendimin paraprak në prill, që MD të vazhdojë me procesin e miratimit të këtyre ndryshimeve brenda qershorit 2014.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në lidhje me imunitetit, projektligji është ende në Kuvend. 	Ministria e Drejtësisë	<p>2014/2015</p> <p>Prill/qershor 2014</p> <p>Projektet janë hartuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe i janë dërguar Komisionit të Venecias për mendim. Jemi në pritje të rekomandimeve konkrete.</p> <p>Realizuar.</p> <p>Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale janë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile synojnë: <ul style="list-style-type: none"> - Kufizimin e kompetencave të Gjykatës së Lartë (për çështjet penale); - Përcaktimin e sanksioneve ndaj avokatëve që mungojnë në seanca gjyqësore. 		<p>miratuar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë</p> <p>Brenda marsit 2014 (draftet i janë dërguar Komisionit të Venecias për komente).</p>
2. Kryerja e vlerësimit të nevojave në lidhje me burimet njerëzore dhe financiare të Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve gjyqësore			
Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
2.1	<p>Lançimi i një procesi konsultimi lidhur me burimet njerëzore dhe financiare të Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemit gjyqësor, ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë, nëse është e nevojshme, nëpërmjet asistencës teknike ndërkombëtare.</p> <p>2.1.1. Kontribuimi dhe angazhimi për vlerësimin dhe përfshirjen në agjendën e Bordit Ekzekutiv të Zyrës për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor të një procesi konsultimi në lidhje me rivlerësimin e nevojave financiare të Gjyqësorit, e cila është pjesërisht e realizuar.</p> <p>Vlerësimi lidhur me burimet njerëzore është miratuar në Ligjin për Buxhetin 2014, në përputhje me projektbuxhetin e propozuar nga Bordi Ekzekutiv i ZABGJ-së. Projektpropozimi i ZABGJ-së konsiston në dy elemente: a) kërkesa për burime njerëzore dhe kërkesa për burime financiare. Kërkesa për</p>	<p>ZABGJ, Gjykata e Lartë, Konferenca Gjyqësore Kombëtare, Ministria e Drejtësisë</p>	2014
		ZABGJ , Ministria e Drejtësisë	15.1. 2014 Takimi i Bordit Ekzekutiv të ZABGJ-së (çdo tremujor)

	<p>burime njerëzore është e finalizuar, mbetet për t'u finalizuar rivlerësimi për burime financiare.</p> <p>2.1.2. Kontribuimi dhe angazhimi për vlerësimin dhe përfshirjen në agjendën e mbledhjes së Konferencës Gjyqësore Kombëtare të një procesi konsultimi në lidhje me rivlerësimin e nevojave financiare të Gjyqësorit, në raport me statusin aktual</p> <p>Vlerësimi lidhur me burimet njerëzore është miratuar në ligjin për buxhetin 2014, në përputhje me propozimet e Komisionit të Buxhetit dhe Këshillit Ekzekutiv të Konferencës Gjyqësore Kombëtare.</p>	<p>Konferenca Gjyqësore Kombëtare (mbledhja e Konferencës Gjyqësore Kombëtare), Ministria e Drejtësisë</p>	<p>5-mujori i parë 2014</p>
<p>3. Përmirësimi i sistemit të emërimit, vlerësimit, ngritjes në detyrë dhe transferimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve</p>			
Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
3.1	<p>Modifikimi i rregullave për emërimet, transferimet dhe promovimet në mënyrë që vendimet për karrierën e gjyqtarëve të bëhen në bazë të vlerësimit të tyre, të meritës dhe në bazë të kriterëve të tjera objektive (duhet marrë parasysh opinioni i Komisionit të Venecias).</p> <p>3.1.1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.</p> <p>3.1.2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”.</p>	<p>KLD, Ministria e Drejtësisë</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>2014/2015</p> <p>4-mujori i tretë i 2014</p> <p>4-mujori i tretë i 2014</p>

	<p>3.1.3. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në kuadër të rritjes së performancës së gjyqësorit;</p>		
		Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014
	<p>3.1.4. Projektligji “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve” në kuadër të krijimit të një procesi të barazuar në meritë dhe transparencë ne emërimet, transferimet, promovimet e gjyqtarëve dhe për të reduktuar diskrecion që gëzon Këshilli i Lartë i Drejtësisë.</p>	Ministria e Drejtësisë	<p>4-mujori i tretë i 2014</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka përgatitur tashmë projektligjin “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”. Projekti është shpërndarë për mendim tek të gjithë aktorët e drejtësisë dhe organizmat ndërkombëtarë që na sistojnë në reformën në drejtësi.</p>
3.2	Përdorimi i kriterit të "integritetit" në procesin rekrutimit, vlerësimit dhe promovimit të magjistratëve.	KLD	2014 dhe në vazhdimësi
3.3	<p>Modifikimi i rregullave të brendshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në të gjitha aspektet që lidhen me karrierën, në mënyrë që vendimet e saj të jenë të arsyetuara në mënyrë të rregullt dhe t’i nënshtrohen ankesës (do të merret parasysh opinionimi i Komisionit të Venecias).</p> <p>3.3.1. Konsolidimi i listës së përhershme të gjyqtarëve ku tregohet edhe rangu.</p>	KLD	2014/2015
		KLD	Realizuar Përditësimi - 2014 dhe në vazhdimësi

3.4	<p>Rishikimi i sistemit të vlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët në bazë të kriterëve të qarta, transparente dhe të orientuara drejt nxitjes (duke përfshirë dispozitat për ankesat, monitorimin, rrugët e ngritjes në karrierë, ulje në gradë, etj.) me qëllim përfundimin dhe përditësimin e sistemit aktual të vlerësimit (do të merret parasysh opinioni i Komisionit të Venecias).</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka përgatitur tashmë projektligjin “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtareve”. Projekti është shpërndarë për mendim tek të gjithë aktoret e drejtësisë dhe organizmat ndërkombëtarë që na sistojnë në reformën në drejtësi.</p> <p>3.4.1. Përfundimi i vlerësimit profesional dhe etik të gjithë gjyqtarëve për vitet 2005-2006;</p> <p>3.4.2. Mbledhja e dokumentacionit për vlerësimin profesional dhe etik për të gjithë gjyqtarët dhe fillimi i vlerësimit për 2007-2009;</p> <p>Kryhet bazuar në programin e miratuar me vendimin nr. 413, datë 16.12.2013 të KLD-së. Sipas këtij programi, radha e gjykatave është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Juridiksioni i Apelit Durrës, që përmbledh Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Kavajë, Durrës dhe Elbasan; 2. Juridiksioni i Apelit Vlorë, që përmbledh Gjykatën e Apelit Vlorë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Lushnjë, Berat, Fier dhe Vlorë; 3. Juridiksioni i Apelit Gjirokastër, që përmbledh Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet. 	KLD/Ministria e Drejtësisë	2014/2015
		KLD	Përfunduar Janar 2014
		KLD	Periodikisht gjatë 2014
		KLD	Brenda vitit 2014 do të miratohen vlerësimet profesionale dhe etike për pothuajse 50 % të gjyqtarëve.

	<p>4. Juridiksioni i Apelit Korçë, që përmbledh Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Korçë dhe Pogradec;</p> <p>5. Juridiksioni i Apelit Shkodër. që përmbledh Gjykatën e Apelit Shkodër dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Lezhë, Shkodër, Kukës dhe Tropojë.</p> <p>6. Juridiksioni i Apelit Tiranë, që përmbledh Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Kurbin, Krujë, Mat, Dibër.</p> <p>7. Juridiksioni i Apelit për Krime të Rënda, që përmbledh Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.</p> <p>3.4.3. Shqyrtimi dhe miratimi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve për periudhën 2007-2009.</p>		
	<p>3.4.4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të parashikuara në Progres Raportin e BE-së;</p>	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
	<p>3.4.5. Projektligji “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve” në kuadër të krijimit të një procesi të barazuar në meritë dhe transparencë në emërimet, transferimet, promovimet e gjyqtarëve dhe për të reduktuar diskrecion që gëzon Këshilli i Lartë i Drejtësisë.</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka përgatitur tashmë projektligjin “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”. Projekti është shpërndarë për mendim tek të gjithë aktorët e drejtësisë dhe organizmat ndërkombëtarë që na sistojnë në reformën në drejtësi.</p>	Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës

3.5	<p>Rritja e kompetencave të Këshillit të Prokurorëve në lidhje me promovimin, emërimin dhe transferimin (do të merret parasysh opinioni i Komisionit të Venecias).</p> <p>3.5.1. Vlerësimi dhe analiza e ndryshimeve të mundshme në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” i ndryshuar, në lidhje me rolin dhe kompetencat e Këshillit të Prokurorëve.</p> <p>3.5.2. Organizmi i seancave dëgjimore nga Këshilli i Prokurorisë për rastet e konkurrimit për ngritje në detyrë apo për drejtues prokurorie, krahas konkurrimit me dosje;</p> <p>3.5.3. Organizimi i konkurrimit me shkrim dhe seancave dëgjimore nga Këshilli i Prokurorisë për emërimin e kandidatëve për prokuror, që nuk vijnë nga radhët e magjistratëve dhe që plotësojnë kushtet e nenit 18 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, i ndryshuar;</p> <p>3.5.4. Ngritja e Komisionit të Verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore të kandidatëve, me pjesëmarrjen e dy anëtarëve të Këshillit dhe një punonjësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i cili raporton me shkrim para Këshillit të Prokurorisë;</p> <p>3.5.5. Rishikimi i Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit të Prokurorisë.</p>	Ministria e Drejtësisë/Prokuroria e Përgjithshme	2014/2015
		Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
		Prokuroria e Përgjithshme	6-mujori i dytë i 2014-ës
		Prokuroria e Përgjithshme	6-mujori i dytë i 2014-ës
		Prokuroria e Përgjithshme	6-mujori i dytë i 2014-ës
		Prokuroria e Përgjithshme	6-mujori i dytë i 2014-ës
3.6	<p>Garantimi i llogaridhënies së sistemit për hyrjen në Shkollën e Magjistraturës dhe në karrierën gjyqësore.</p> <p>3.6.1. Konkursi i Rekrutimit të Kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë</p>	Shkolla e Magjistraturës	Takimet e Bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës (periodike)
		Shkolla e Magjistraturës	Shtator 2014

4. Reduktimi i çështjeve të prapambetura/akumuluar			
Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
4.1	Vendosja e një sistemi për të fuqizuar gjyqtarët që të sanksionojnë në mënyrë efektive avokatët për mospërfillje ndaj gjykatës, duke përfshirë mungesa të përsëritura gjatë seancave.	Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
	4.1.1. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile Projektligjet për këtë qëllim (ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile, që synojnë kufizimin e kompetencave të Gjykatës së Lartë për çështjet penale, si edhe parashikojnë sanksione ndaj avokatëve në rast mungese në seanca gjyqësore janë përgatitur tashme nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe i janë dërguar për mendim Komisionit të Venecias.	Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
4.2	Shtrirja e sistemit të menaxhimit të çështjeve ICMIS në të gjitha gjykatat; kontrolli mbi funksionimin e caktimit të mekanizmit të hedhjes së shortit. 4.2.1. Instalimi i sistemit dhe trajnimin e të gjithë personelit administrativ dhe të gjyqtarëve, në mënyrë që të fillojë regjistrimi dhe përpunimi i rasteve në mënyrë elektronike (rrjedhja e punës). Për gjykatat që nuk kanë filluar të aplikojnë sistemin	Ministria e Drejtësisë	Gjatë 2014
		Ministria e Drejtësisë	Janar – shkurt 2014

	<p>ICMIS, Ministria e Drejtësisë do të organizojë trajnimin e përdoruesve të këtij sistemi elektronik, i cili përfshin stafin administrativ (kancelar, sekretare regjistruese, sekretare seance), si dhe trupën gjyqësore (Kryetarin e Gjykatës, gjyqtarët).</p> <p>4.2.2. Trajnime shtesë për gjyqtarët mbi funksionimin e sistemit ICMIS.</p> <p>4.2.3. Investimi në infrastrukturë elektronike në gjykata administrative përputhje me sistemin ICMIS: Konkretisht, do të sigurohen 6 servera (me përjashtim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë); 63 komplete kompjuter – ups; 54 printera; 5 fotokopje për stafin e gjykatave administrative, si dhe 6 monitorë për informacionin ndaj publikut në holle.</p> <p>Ministria e Drejtësisë do të instalojë sistemin ICMIS dhe do të organizojë punën për zbatimin, trajnimet fillestare dhe vënien në funksionim të plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, pas sigurimit të infrastrukturës së nevojshme me fonde te ZABGJ.</p>	Ministria e Drejtësisë	Çdo tremujor 2014
		Ministria e Drejtësisë	2014
4.3	<p>Përmirësimi i infrastrukturës në gjykata.</p> <p>4.3.1. Rehabilitimi i godinave për përmirësimin e kushteve të punës dhe gjykimit në 4 gjykata.</p> <p>Investimet në 4 gjykata rrethi gjatë vitit 2014:</p>	ZABGJ	
		ZABGJ dhe gjykatat ³	6-mujori i dytë 2014

	<ul style="list-style-type: none"> - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, - Gjykata e Apelit Durrës, - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. <p>Disa nga arsyet që çuan në ndryshime në master-planin e investimeve në godinat e gjykatave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mundësi reale për sheshe ndërtimi apo rikonstruksion godinash të gjykatave; - Ndryshimi i numrit të gjyqtarëve në gjykata; - Ndryshimi i prioriteteve të investimeve, për shkak të veprimtarisë së gjykatave administrative; - Buxhetit të disponueshëm gjatë kësaj periudhe. <p><i>Investimet e parashikuara:</i></p> <p>Në kuadrin e projektit IPA, parashikohet ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë ku të akomodohen Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit e zhvillon veprimtarinë në dy godina ku ndodhen Seksionet Penale dhe Civile.</p> <p>4.3.2. Ndërtim i godinës së re për Gjykatën e Apelit Shkodër</p> <p>4.3.3. Investime në infrastrukturën elektronike, nëpërmjet shtimit apo zëvendësimit të pajisjeve elektronike në 22 gjykata.</p> <p>4.3.4. Investime në infrastrukturën ndërtimore për krijimin e kushteve të punës dhe gjykimit në 2 gjykata administrative.</p> <p>4.3.5. Investim për rritjen e sipërfaqes së punës për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.</p> <p>4.3.6. Investime në infrastrukturën elektronike, nëpërmjet shtimit të pajisjeve elektronike në 7 gjykata administrative.</p>		
		ZABGJ dhe gjykatat	6-mujori i dytë 2014
		ZABGJ dhe gjykatat	6-mujori i dytë 2014
		ZABGJ dhe gjykatat	6-mujori i dytë 2014
		ZABGJ dhe gjykatat	6-mujori i dytë 2014

		ZABGJ dhe gjykatat	6-mujori i dytë 2014
4.4	<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”</p> <p>Kjo nismë do të synojë ndryshimin e disa dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, për harmonizimin e dispozitave të tij me nismat ligjore të ndërmarra së fundmi për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së.</p>	Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
4.5	<p>Zhvillimi dhe promovimi i sistemeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësor.</p> <p>Miratimi i ligjit “Për arbitrazhin”.</p>	Ministria e Drejtësisë	4-mujori i tretë i 2014-ës
5. Përmirësimi i kontrollit ndaj gjyqtarëve dhe gjykatave			
Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
5.1	<p>Reformimi i sistemit të inspektimit, duke i dhënë më shumë fuqi inspektorëve, duke përforcuar pavarësinë e tyre dhe duke rritur numrin e inspektimeve (duke marrë parasysh opinionin e Komisionit të Venecias).</p> <p>5.1.1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.</p> <p>Zbatimi i masave sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias</p>	<p>MD, KLD</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>2014/2015</p> <p>Shtator – dhjetor 2014</p> <p>Q3 2014</p>

	<p>5.1.2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke adresuar rekomandimet e Progres-Raportit të KE-së.</p> <p>Zbatimi i masave sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Shtator – dhjetor 2014</p>
<p>5.2</p>	<p>Të sigurohet se shkeljet e konstatuara nga inspektorët të dërgohen në Prokurori.</p>	<p>KLD, Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Përgjatë vitit 2014</p>
<p>5.3</p>	<p>Modifikimi i sistemit të sanksioneve disiplinore në funksion të zgjerimit të gamës së sanksioneve dhe përshtatjen e tyre me vepra të ndryshme.</p> <p>- Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në kuadër të rritjes së performancës së gjyqësorit;</p>	<p>Kuvendi, Ministria e Drejtësisë</p>	<p>4 maji i tretë i 2014-ës MD dhe KLD gjykojnë se dispozitat në lidhje me sanksionet në ligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, lidhur me sanksionet janë të plota dhe shteruese.</p> <p>N.B. Komisioni gjykon se ndryshimet në sistem duhet të përfshijnë një gamë më të gjerë sanksionesh (përveç paralajmërimit dhe shkarkimit). KE-ja do të japë hollësi për këtë.</p>

5.4	Rritja e bashkëpunimit ndërmjet inspektoratit gjyqësor dhe agjencive antikorrupsion.	KLD, ILDKP, MD	2014 e në vazhdimësi
	5.4.1. Ndjekja e zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit me ILDKP-në (shih pikën 3.3 për prioritetin kyç të antikorrupsionit)	Ministria e Drejtësisë/ ILDKP	2014 e në vazhdimësi
	5.4.2. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet/agjencitë që luftojnë korrupsionin	Ministria e Drejtësisë	2014 e në vazhdimësi
	<p>2.1.7 Përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe viktimave të trafikut në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, për të ndihmuar hetimet kundër krimit të organizuar.</p> <p>2.1.7.1 Miratimi i projektvendimit “Për mbrojtjen e veçantë të personave që ndihmojnë policinë dhe punonjësit e policisë, që u kërcënohet jeta, familja dhe prona, për shkak të detyrës”.</p>	<p>MPB Policia e Shtetit Prokuroria për Krimet e Rënda</p> <p>MPB Policia e Shtetit</p>	<p>Në vijimësi</p> <p>Maj 2014</p>
	<p>2.1.8 Mbështetja e strukturave të hetimit të krimit të organizuar në produktet analitike të hartuara nga strukturat e analizës së informacionit kriminal me qëllim orientimin e hetimeve proaktive.</p>	<p>Policia e Shtetit, PP</p>	<p>Çdo vit</p>
<p>Forcimi i kapaciteteve të policisë për t’iu përgjigjur në kohën dhe mënyrën e duhur të gjitha kërkesave të prokurorisë për aplikimin e mjeteve speciale të hetimit</p>			
<p>2.2</p>	<p>2.2.1 Kryerja e procesit të reformimit të Policisë së Shtetit, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe strukturor.</p> <p>2.2.1.1 Aktet në vijim do të shqyrtohen dhe miratohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projektligji "Për Policinë e Shtetit"; -; - Projektligji "Për përdorimin e armëve të zjarrit"; - Projektligji “Për armët”, - Projektligji “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” - Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Akademisë së Sigurisë Publike, jashtë sistemit të arsimit të lartë publik” <p>2.2.1.2. Hartimi dhe miratimi i strategjisë të Policisë së Shtetit për vitet 2014-2020.</p> <p>2.2.1.3 Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i Policisë së Shtetit do të përfundojë në mënyrë që të jepet një gjendje reale e Policisë së Shtetit, në bazë të të cilave do të ndërtohet reforma e Policisë së Shtetit.</p> <p>2.2.1.4 Përmirësimi strukturor për Policinë e Shtetit do të kryhet për të rritur performancën e strukturave qendrore dhe vendore.</p>	<p>MPB, Policia e Shtetit</p> <p>MPB, Policia e Shtetit</p> <p>MPB, Policia e Shtetit</p> <p>MPB, Policia e Shtetit</p> <p>MPB, Policia e Shtetit</p>	<p>Gjatë vitit 2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>Korrik 2014</p> <p>Prill 2014</p> <p>Prill 2014</p>

	<p>2.2.2 Riorganizimi i strukturës dhe rritja e numrit të punonjësve të Policisë në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacioneve.</p> <p>2.2.3 Rishikimi i bazës ligjore dhe të akteve legjislative të strukturës organizative të Forcave të Posaçme të Operacioneve Speciale me qëllim për ta përmirësuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i një akti normativ për aplikimin e mbikëqyrjes/përgjimit të mjedisit, si dhe një rregullore për procedurat standarde të shërbimeve; • Hartimi i një akti normativ "Për teknikat e fshehta të vëzhgimit të policisë"; • Hartimi i një akti normativ "Për aplikimin e metodës speciale hetimore të veprimeve simuluese dhe infiltruese"; • Hartimi i një akti për trajtimin e agentëve të infiltruar gjatë ushtrimit të detyrës dhe ecurisë së tyre pas përfundimit të detyrës. <p>2.2.4 Trajnimi i efektivit të këtyre njësive.</p> <p>2.2.5 Blerje logjistike të përshtatshme për të zbatuar detyrat e përcaktuara.</p> <p>Sigurimi i teknologjisë së përparuar për përgjim mjedisor.</p> <p>Përmirësimet në mbështetjen logjistike, veçanërisht në drejtim të mjeteve motorike dhe të infrastrukturës teknike.</p>	<p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit</p>	<p>2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>Qershor 2014</p> <p>Mars 2014</p> <p>2014</p> <p>Qershor 2015</p>
--	--	---	--

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Policisë Kufitare dhe Migracionit (PKM) dhe Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)			
2.3	2.3.1. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe planin e saj të veprimit për periudhën 2014-2020”.	Policia e Shtetit	Maj 2014
	2.3.2 Hartimi dhe nënshkrimi i urdhrat të përbashkët ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e tjera.	MPB Policia e Shtetit PKM	Gjysma e parë 2014
	2.3.3 Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në QNOD përmes: 2.3.3.1 Përmirësimit të rregullave dhe angazhimit të institucioneve në fushën operacionale, administrative dhe në çështjet buxhetore. 2.3.3.2 Standardizimit e përmirësimit të procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mes institucioneve.	QNOD MPB PKM MF	Shtator 2014 Nëntor 2014
	2.3.4 Rritja e kapaciteteve survejuese, operacionale dhe monitoruese për parandalimin dhe luftën ndaj aktiviteteve kriminale që kryhen në hapësirën detare. 2.3.4.1 Vënia në kapacitet të plotë i sistemeve të nevojshme për survejimin, monitorimin, identifikimin dhe komunikimin në hapësirën detare (ISSSS, Blue Box, AIS, Tetra etj).	QNOD MPB PKM QNOD	Dhjetor 2014 Tetor 2014

<p>2.3.4.2 Organizimi i trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta ndërmjet institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë.</p> <p>2.3.4.3 Hartimi i një agjende të përbashkët ndërmjet QNOD-së, misioneve PAMECA IV dhe ICITAP për observimin, monitorimin dhe kontrollin e kufirit blu.</p>	<p>QNOD</p> <p>QNOD</p>	<p>Tetor 2014</p> <p>Maj 2014</p>
<p>2.3.5 Krijimi i një platforme ndërinstytucionale për vlerësimin e riskut:</p> <p>2.3.5.1 Krijimi i kornizës ndërinstytucionale për identifikimin dhe vlerësimin e riskut në hapësirën detare.</p> <p>2.3.5.2 Krijimi i grupit ndërinstytucional për vlerësimin e ngjarjeve (operacioneve).</p> <p>2.3.5.3 Ngritja e bazës së të dhënave ndërinstytucionale me të dhëna dhe informacione për identifikimin dhe vlerësimin e riskut.</p> <p>2.3.5.4 Trajnimi i stafit për identifikimin dhe vlerësimin e riskut.</p>	<p>QNOD</p> <p>QNOD</p> <p>QNOD</p> <p>QNOD</p> <p>QNOD</p>	<p>Dhjetor 2014</p> <p>Shtator 2014</p> <p>Prill 2014</p> <p>Nëntor 2014</p> <p>Dhjetor 2014</p>
<p>2.3.6 Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta me strukturat e tjera policore.</p> <p>2.3.6.1 Trajnim i përbashkët i PKM dhe strukturave antitrafik lidhur me identifikimin dhe asistencën ndaj viktimave të trafikimit.</p>	<p>PKM</p> <p>Policia e Shtetit PKM</p>	<p>2014</p> <p>2014</p>

	2.3.6.2 Vazhdimi i trajnimit të përbashkët të PKM dhe strukturave antidrogë, me qëllim zbulimin, hetimin dhe kapjen e drogave.	Policia e Shtetit	Gjysma e parë 2014
Monitorimi i situatës pas liberalizimit të vizave			
2.4	2.4.1 Ngritja e një Task Force ndërinstucionale për të monitoruar situatën pas liberalizimit të vizave.	MPB, Policia e Shtetit, MPÇV, MMSR, M PJ	Gjysma e parë 2014
	2.4.2 Takime me aktorët kryesorë: ambasada të vendeve të BE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.	MPB	Çdo tremujor
	2.4.3 Fushata sensibilizuese (debate televizive, debate, konferenca shtypi, takime sensibilizuese me komunitet për fusha problematike, spote televizive).	MPB	Prill – qershor 2014

Nr.	Masat /aktivitetet	Përgjegjësia / institucioni	Afati /data
FORCIMI I HISTORIKUT			
3. Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve e municioneve luftarake, të mjeteve motorike dhe veprave të artit e kulturës			
Fuqizimi i strukturave dhe procedurave për identifikimin dhe ndihmën e viktimave të trafikimit, rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe ndjekjes penale			
	3.1.1 Hartimi i Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2014 – 2016.	MPB – Njësia Antitrafik	Gjysma e parë 2014

3.1	3.1.2 Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për përmirësimin e dispozitave për rritjen e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit.	MD, MPB, PP me institucionet e pavarura dhe shoqërinë civile	T4 2014
	Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për të përmirësuar aksesin në drejtësi për viktimat e trafikimit.		
	3.1.3 Ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 5.1.2002 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”.	MPB – Njësia Antitrafik, KSHLKTQNJ	Gjysma e parë 2014
	3.1.4 Ndryshimi i urdhrit të përbashkët nr. 1192, datë 19.5.2006, për krijimin e Autoritetit Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit.	Anëtarët e MKR-së, Autoriteti Përgjegjës	T1 2014
	3.1.5 Monitorimi dhe zbatimi Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) dhe Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit.	Task Forca e MKR-së, Autoriteti Përgjegjës	Çdo 6 muaj
Forcimi i luftës kundër trafikimit të brendshëm, veçanërisht të fëmijëve, përmes rritjes së kapaciteteve të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe referimin e viktimave tek shërbimet komunitare për riintegrimin e tyre			
3.2	3.2.1 Hartimi i një udhëzimi për oficerët e Policisë së Shtetit dhe prokurorët specialë mbi ndryshimet e fundit të Kodit Penal që adresojnë trafikimin e brendshëm dhe sugjerimet e PKM dhe NJAT.	MPB – Njësia Antitrafik, Prokuroria e Përgjithshme	Gjysma e parë 2014
	3.2.2 Zhvillimi i një workshopi me pjesëmarrjen e oficerëve të policisë, prokurorëve, punonjësve socialë, inspektoratit të punës me temë “Trafikimi i brendshëm i fëmijëve: sfidat dhe zgjidhjet”.	MPB – Njësia Antitrafik, Prokuroria e Përgjithshme	T1 2014

	3.2.3 Zhvillimi i takimeve mujore me drejtoritë e policive në qark dhe prokurorët specialë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda që merren me trafikimin e personave me tematikë specifike “Trafikimi i brendshëm”.	Policia e Shtetit , Njësia Antitrafik, PP	Çdo muaj
	3.2.4 Organizimi i trajnimeve me punonjës të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve mbi identifikimin më të mirë të rasteve të trafikimit të brendshëm të personave.	Njësia Antitrafik , AAPSK	Gjysma e dytë 2014
	3.2.5 Trajnime me oficerët e PKM-së, mbrojtjes së të miturve dhe antitrafikut në 12 drejtoritë rajonale.	Policia e Shtetit , Njësia Antitrafik	Gjysma e dytë 2014 dhe në vijimësi
	3.2.6. Riaktivizimi i databazës për viktimat / viktimat potenciale të trafikimit “SIVET”.	Njësia Antitrafik	Gjysma e parë 2014
Përafrimi i legjislacionit për luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve			
3.3	3.3.1 Harmonizimi i legjislacionit për armët e zjarrit me <i>acquis</i> e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. 3.3.1.1. Miratimi i projektligjit “Për armët”. 3.3.1.2 Ngritja e Regjistrit Kombëtar të Armëve të Zjarrit.	MPB MM Policia e Shtetit	2015 Maj 2014 Shtator 2015

Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese			
3.4	3.4.1. Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë për të organizuar trajnime të përbashkëta në fushën e luftës ndaj trafikëve.	MPB Policia e Shtetit, PP	Dhjetor 2014
	3.4.2 Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar për veprat e artit dhe kulturës.	MPB Policia e Shtetit, PP, MKTRS	Qershor 2014, Dhjetor 2014
	3.4.3 Forcimi i kapaciteteve të specialisteve nëpërmjet organizimit të 2 trajnimeve në vit, me 24 përfitues, mbi teknikat e hetimeve proaktive në rastet e trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht për trafikimin e brendshëm në bashkëpunim me Prokurorinë për Krimet e Rënda, që do të rezultojë në rritjen me 10 % të hetimeve proaktive në luftën kundër trafikëve të paligjshme.	MPB Policia e Shtetit, MPÇSSH	Qershor 2014, Dhjetor 2014
Parandalimi dhe goditja e trafikimit të qënieve njerëzore, si dhe i trafikëve të tjera, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese			
3.5	3.5.1. Analizimi i situatës kriminale në lidhje me trafikët, si edhe monitorimi i detyrimeve të parashikuara në Planin e Veprimit për trafikimin e automjeteve dhe veprave të artit e kulturës.	MPB Policia e Shtetit, PP Ministria e Kulturës, Ministria e Transportit, SHISH	TI 2014
	3.5.2 Hartimi i produkteve analitike në funksion të efektivitetit të goditjes së individëve, grupeve dhe organizatave kriminale me veprimtari në fushën e trafikëve të paligjshme.	Policia e Shtetit	Fundi i 2014

	3.5.3 Rritja me 10% e numrit të hetimeve proaktive dhe procedimeve në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore dhe trafikeve të tjera, nëpërmjet përdorimit të teknikave speciale të hetimit dhe bashkëpunimit me Prokurorinë.	Policia e Shtetit PP	2014
	3.5.4 Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2014-2016 për luftën kundër trafikimit të automjeteve dhe veprave të artit e kulturës.	MPB, Policia e Shtetit, PP Ministria e Kulturës, Ministria e Transportit	T1 2014
	3.5.5 Organizimi i takimeve periodike të aktorëve të përfshirë në plan veprimi, si dhe kryerja e analizave të përbashkëta me ta.	Policia e Shtetit PP	Çdo tremujor

Nr.	Masat/aktivitetet	Përgjegjësia/ institucioni	Afati /data
4. Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parasë			
Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave dhe rritja e treguesve për luftën kundër tij			
	4.1.1. Kryerja e analizave të mangësive për strukturën aktuale ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal.	PP Policia e Shtetit	Korrik 2014
	4.1.1.2 Kryerja e analizave ligjore mbi mundësinë e përfshirjes së veprës penale të pastrimit të parave edhe në juridiksionin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, për ato raste kur janë të lidhura me veprën penale kryesore në kompetencë të Krimeve të Rënda.	MD MF DPPPP	T3 2014

4.1	4.1.2 Rritja me 5% e numrit të hetimeve dhe dënimeve përmes përdorimit intensiv të Raportimit të Transaksioneve të Dyshimta dhe hetimeve proaktive të pasurisë së pajustificuar.	Policia e Shtetit DPPPP, MD, PP	Dhjetor 2014
	4.1.2.1. Rritja e rasteve referuar autoriteteve ligjzbatuese lidhur me Raportimin e Transaksioneve të Dyshimta (RAD) dhe hetime të tjera proaktive për shkak të pasurisë së pajustificuar.	DPPPP	Dhjetor 2014
	4.1.3 Përmirësimi dhe forcimi i kapaciteteve të hetimit financiar, me fokus pastrimin e parasë dhe sekuestrimin e pasurisë.	MPB Policia e Shtetit DPPPP	Dhjetor 2014
	4.1.3.1 Kryerja e një vlerësimi të nevojave në strukturat që merren me luftën kundër pastrimit të parave.	Policia e Shtetit DPPPP,	Qershor 2014
	4.1.3.2. Hartimi i një plani veprimi për forcimin e kapaciteteve të hetimit financiar.	PP	Shtator 2014
4.1.4 Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetit profesional të strukturave të hetimit të pastrimit të parave.	Policia e Shtetit PP	Fundi i 2014	
4.1.4.1 Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta me pjesëmarrës nga Policia, Prokuroria, Tatimet Doganat, DPPPP dhe nga institucionet financiare.	DPPPP, AAPSK, Doganat, Tatimet, MD		
4.1.5. Rritja e efikasitetit të sistemit parandalues të pastrimit të parave.	MF		
4.1.5.1 Analizimi i ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008, të ndryshuar, në kuadër të ndryshimeve të mundshme që vijnë si rezultat i rekomandimeve të FATF dhe direktivave të BE.	DPPPP	2014	

	4.1.5.2 Inspektimi në vend i 70 subjekteve, vendosja e masave administrative për shkeljet që konstatohen dhe ndjekja e rekomandimeve.		Shtator 2014
	4.1.5.3 Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse me rritje 10% të inspektimeve dhe trajnimeve të përbashkëta.		2014
	4.1.5.4 Trajnimi i subjekteve të ligjit dhe rritja me 10% e numrit të personave të trajnuar.		2014
	4.1.5.5 Analizimi i riskut që mbart sektori i shoqërive të transfertave, pasuritë e paluajtshme dhe transporti ndërkufitar i parasë në procesin e pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale.		2014
	4.1.5.6 Zhvillimi i trajnimeve mbi subjektet e ligjit, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse (NJIF).		Shtator 2014
	4.1.6 Rishikimi i vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT dhe vënia në dispozicion për agjencitë e zbatimit të ligjit.	MF DPPPP	Fundi i 2014-ës

Nr.	Masat /aktivitetet	Përgjegjësia/institucioni	Afati /data
5. Rritja e sekuestimeve dhe konfiskimeve të aseteve kriminale nëpërmjet implementimit efektiv të ligjit antimafia (ligji nr. 10192, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”)			
Rishikimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore në drejtim të gjetjes, sekuestrimit, konfiskimit të aseteve kriminale			
5.1	5.1.1 Inicimi i ndryshimeve në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Antimafia.	PP MF, AAPSK, MPB, MD	Maj 2014

	5.1.2 Rishikimi i akteve të tjera nënligjore që përmirësojnë punën në drejtim të kryerjes së hetimeve pasurore, sekuestrimeve dhe konfiskimeve dhe menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara	MPB PP, MF	Tetor 2014
Rritja dhe forcimi i kapaciteteve profesionale në hetimin e pasurive kriminale			
5.2	5.2.1. Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese të përbashkëta me institucione tjera që mbartin detyrime nga ligji nr. 10192 (Antimafia).	Policia e Shtetit PP, MF	2014
	5.2.1.1 Zhvillimi i dy workshopeve “Investigimi i veprave të pastrimit të parave me fokus në asetet kriminale” financuar nga instrumenti TAIEX.	Policia e Shtetit PP	
	5.2.2 Zhvillimi i takimeve periodike të grupit ndërinstitutional të ekspertëve, me qëllim: - Analizimin e ecurisë së hetimeve pasurore dhe nxjerrjen e rekomandimeve për përmirësimin e punës. - Mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.	Policia e Shtetit PP MF	Në vijimësi Çdo tremujor
	5.2.3 Shqyrtimi i mundësisë së stimulimit të strukturave të përfshira në hetimin e aseteve kriminale, nëpërmjet caktimit të një përqindje nga vlera e aseteve të konfiskuara, për rritjen e kapaciteteve investigative të këtyre strukturave.	MF	2014
	5.2.3.1 Blerja e pajisjeve të nevojshme për personalin e strukturave të hetimit të aseteve kriminale në Policinë e Shtetit, nga fondi i dhënë nga Ministria e Financave, me qëllim rritjen e kapaciteteve të strukturave që merren me hetimin e aseteve kriminale.	MPB	T1 2014

	5.2.3.1.1 Kanë nisur procedurat e prokurimit për sigurimin e 50 kompjuter, 50 printerë, 5 lap-topë, 5 skaner, 15 kamera digjitale, 1 fotokopje dhe 2 projektorë.	Policia e Shtetit	Qershor 2014
Rritja me 5 % e numrit të hetimeve pasurore të referuara në Prokurorinë për Krimet e Rënda që do të bëjë të mundur rritjen e numrit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2014.			
5.3	5.3.1 Rritja e bashkëpunimit me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe strukturat e policisë që hetojnë veprat penale objekt i fushës së zbatimit të ligjit.	Policia e Shtetit PP MF AAPSK	2014
	5.3.2. Rritja e cilësisë së hetimeve pasurore, nëpërmjet rritjes së monitorimit dhe analizave të posaçme mes strukturave të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë për Krime të Rënda.	Policia e Shtetit PP MF	Çdo tremujor
Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimet ndaj pasurisë			
5.4	5.4.1 Shtimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët ndërkombëtarë.	Policia e Shtetit PP, MF Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar	Në vijimësi
	5.4.1.1 Organizimi i takimeve të rregullta me oficerë ndërlidhës të vendeve partnere për të diskutuar mbi problemet e hasura gjatë zbatimit të Ligjit Antimafia, me qëllim shkëmbimin e informacionit të vlefshëm për hetimin e pasurisë së krimit.		
	5.4.1.2 Mbajtja e kontakteve me rrjetin CARIN, që të merret përvoja dhe informacion i vlefshëm për hetimet e pasurisë së krimit.		

	5.4.2 Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe operacionale.	Policia e Shtetit	Në vijimësi
	5.4.3 Shkëmbimi i eksperiencave më të mira me strukturat homologe.	Policia e Shtetit	Në vijimësi

Nr.	Masat /aktivitetet	Përgjegjësia/ institucioni	Afati /data
6. Rritja e efektivitetit të strukturave kundër krimit kompjuterik			
Rritja e kapaciteteve administrative të strukturave të luftës kundër krimit kompjuterik			
6.1	6.1.1 Ristrukturimi i njësive policore që merren me krimin kompjuterik.	Policia e Shtetit	Dhjetor 2014
	6.1.2 Ngritja e një strukture të specializuar pranë Prokurorisë për ndjekjen e krimeve kompjuterike.	PP	Korrik 2014
	6.1.3 Rritja e efektivitetit të punës hetimore të strukturave të hetimit të krimit kompjuterik, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve teknike për këqyrjen dhe kontrollin e të dhënave kompjuterike.	Policia e Shtetit	T 1 2014
	6.1.3.1 Sigurimi i harduerëve dhe softuerëve për këqyrjen dhe kontrollin e të dhënave kompjuterike.	Policia e Shtetit	T 1 2014

Fuqizimi i kapaciteteve trajnuese të personelit			
6.2	6.2.1 Zhvillimi i trajnimeve për specialistët.	Policia e Shtetit	Dhjetor 2014
	6.2.2 Rishikimi i përshkrimeve të punës.	Policia e Shtetit	Dhjetor 2014
	6.2.3 Hartimi i procedurave standarde.	Policia e Shtetit	Dhjetor 2014

7. Reduktimit i ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm			
Parandalimi dhe ulja në mënyrë të ndjeshme e prodhimit të drogës në Shqipëri			
Nr.	Masat /aktivitetet	Përgjegjësia/institucioni	Afati /data
7.1	7.1.1 Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit kombëtar kundër kultivimit të bimëve narkotike.	MPB M.Bujqësisë, M.Mjedisit M.Arsimit, SHISH, PP	Deri 30 mars çdo vit
	7.1.2 Ngritja e Shtabit Qendror kundër kultivimit të bimëve narkotike (kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë) dhe shtabeve në qarqe (kryesuar nga prefektët); hartimi e miratimi i planeve të masave në qarqe.	MPB M.Bujqësisë, M.Mjedisit M.Arsimit, SHISH, PP	Deri 15 prill çdo vit
	7.1.3. Zbatimi i Planit të Veprimit: faza parandaluese dhe sensibilizuese (faza I). 7.1.3.1. Zhvillimi i konferencave kombëtare e rajonale për analizimin e situatës dhe sensibilizimin e opinionit publik. 7.1.3.2. Zhvillimi i 12 konferencave, rajonale në nivel qarku; 300	MPB M.Bujqësisë, M.Mjedisit M.Arsimit, SHISH, PP	31 maj çdo vit 31 maj 2014

<p>takimeve dhe aktiviteteve të tjera sensibilizuese në shkolla, fshatra, fokusuar në zonat problematike. Shpalosja e programeve të zhvillimit dhe ato të financimit e subvencionimit për kultura bujqësore, pemëtari, etj.</p> <p>7.1.3.3 Në bashkëpunim me mediat lokale e kombëtare, të organizohen emisione televizive e spote, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik mbi këtë fenomen.</p> <p>7.1.3.4 Përgatitja e shpërndarja e fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera sensibilizuese.</p> <p>7.1.3.5. Zhvillimi i të paktën tre trajnimeve për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike me pjesëmarrjen edhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit dhe shoqërisë civile.</p> <p>7.1.3.6 Zhvillimi i takimeve të përbashkëta me SHISH dhe Prokurorinë për analizimin e situatës dhe koordinimin e punës.</p> <p>7.1.3.7 Mbledhja e analizimi i informacioneve nga gjithë burimet në dispozicion, për zonat e mundshme të kultivimit dhe personat e përfshirë në këtë aktivitet kriminal dhe përgatitja për fazën operationale.</p>		<p>31 maj 2014</p> <p>31 maj 2014</p> <p>31 maj 2014</p> <p>31 maj çdo vit</p> <p>31 maj çdo vit</p>
<p>7.1.4. Zbatimi i fazës operationale të Planit të Veprimit (faza II)</p> <p>7.1.4.1 Të monitorohet territori nga ajri me helikopterët në dispozicion të MPB e MM ose mjete të tjera të siguruara nga partnerët ndërkombëtarë mbi bazën e planeve dhe marrëveshjeve të arritura.</p> <p>7.1.4.2 Të parashikohen efektivat që do të përfshihen në operationet për asgjësimin e bimëve narkotike dhe të sigurohet mbështetja e duhur me mjetet e teknikën e nevojshme për këto lloj operationesh.</p> <p>7.1.4.3 Të kryhen operationet për asgjësimin e bimëve narkotike dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve.</p> <p>7.1.4.4 Të vazhdojë bashkëpunimi me SHISH për identifikimin e</p>	<p>MPB M.Bujqësisë, M.Mjedisit M.Arsimit, SHISH, PP PP</p> <p>MPB Policia e Shtetit</p> <p>MPB Policia e Shtetit, PP</p>	<p>Korrik – tetor çdo vit</p> <p>Korrik–shtator 2014- 2015</p> <p>Korrik – shtator çdo vit</p> <p>25 qershor – gusht çdo vit</p>

	<p>zonave të kultivimit e personat e përfshirë në aktivitet kriminal si dhe me prokurorinë për hetimin e rasteve të kultivimit.</p> <p>7.1.4.5 Zbatimi marrëveshjes së bashkëpunimit me MMPAU për parandalimin e goditjen e rasteve të kultivimit në administrim shtetëror.</p> <p>7.1.4.6 Zbatimi i udhëzimit të përbashkët nr. 7, datë 3.5.2007 me MBUMK për monitorimin e kultivimit të kërpit industrial.</p>	<p>Policia e Shtetit SHISH</p> <p>MB Policia e Shtetit</p>	<p>Maj-gusht çdo vit</p> <p>Maj-gusht Fundi i 2014</p>
Goditja e individëve, grupeve apo organizatave kriminale të përfshira në trafikun dhe tregtimin e drogës brenda dhe jashtë vendit			
7.2	<p>7.2.1 Hartimi i produkteve analitike në funksion të efektivitetit të goditjes së individëve, grupeve dhe organizatave kriminale me veprimtari në fushën e narkotikëve.</p>	Policia e Shtetit	Çdo 6 muaj dhe çdo vit
	<p>7.2.2 Intensifikimi i luftës kundër trafikut dhe rrjeteve të shpërndarjes së drogës, përmes hetimeve kryesisht dhe teknikave speciale të hetimit, bazuar në vlerësimin e kërcënimeve dhe bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit dhe SHISH-it.</p>	Policia e Shtetit PP SHISH	2014-2015
	<p>7.2.2.1 Rritja me 5% e numrit të operacioneve policore ku përdoren Metodrat Speciale të Hetimit, deri në fund të vitit 2014.</p> <p>7.2.2.2 Rritja me 5 % e numrit të grupeve kriminale të trafikut të drogës të goditur nga Policia e Shtetit, deri në fund të vitit 2014.</p>	Policia e Shtetit PP,SHISH	Fundi i 2014-ës
		Policia e Shtetit PP, SHISH	Fundi i 2014-ës

	<p>7.2.3 Përmirësimi i kontrollit kufitar nga Policia Kufitare dhe Doganat kundër trafikut të drogës, përmes përdorimit më efikas të analizës së riskut dhe trajnimeve.</p> <p>7.2.3.1 Vënia në efikasitet të plotë e njësisë së përbashkët për kontrollin e kontejnerëve në Portin e Durrësit.</p>	<p>Policia e Shtetit Doganat</p> <p>Policia e Shtetit Doganat</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Prill 2014</p>
PARTNERITETET DHE GRUPET E INTERESIT			
8. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar			
Nr.	Masat/aktivitetet	Përgjegjësia/ institucioni	Afati /data
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal dhe ndërkufitar në luftën kundër krimit të organizuar			
8.1	<p>8.1.1. Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet e rajonit dhe me vendet e tjera të Bashkimit Evropian dhe më gjerë, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese.</p> <p>8.1.1.1. Nënshkrimi i Protokollit Operacional ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Departamentit të Sigurisë Publike të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë.</p> <p>8.1.1.2. Marrëveshje mes Shqipërisë dhe Turqisë mbi bashkëpunimin e institucioneve të zbatimit të ligjit.</p> <p>8.1.1.3. Marrëveshje mes Shqipërisë dhe Kroacinë për bashkëpunim policor.</p>	<p>MPB</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>MPB</p> <p>Policia e Shtetit MPJ</p>	<p>2014</p> <p>T1 2014</p> <p>Prill 2014</p> <p>Nëntor 2014</p>

<p>8.1.1.4. Marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe Sllovakisë mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm si dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.</p>		2014
<p>8.1.1.5. Marrëveshje me Malin e Zi për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor në Murriqan.</p>		Prill 2014
<p>8.1.1.6. Marrëveshje me Greqinë për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor.</p>		Dhjetor 2014
<p>8.1.1.7. Marrëveshje për hapjen e PKK-së së Përbashkët Grabon-Zatrijebacka Cijena, në kufirin me Malin e Zi.</p>		Nëntor 2014
<p>8.1.1.8. Protokoll mes Shqipërisë dhe Portugalisë për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit mes Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian.</p>		Dhjetor 2014
<p>8.1.1.9. Protokoll i Ripranimit me Greqinë.</p>		Dhjetor 2014
<p>8.1.1.10. Marrëveshje e Ripranimit dhe Protokollit të Zbatimit me Federatën Ruse.</p>		Dhjetor 2014
<p>8.1.1.11. Marrëveshje dhe protokoll Ripranimi me Ukrainën.</p>		Tetor 2014
<p>8.1.1.12 Finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe me Serbinë dhe paraqitja e saj për miratim.</p>		Maj 2014
<p>8.1.1.13. Miratimi i marrëveshjes dypalëshe me Bosnjë-Hercegovinën.</p>		Maj 2014
<p>8.1.1.14 Diskutime dhe miratim i marrëveshjes trepalëshe të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë për luftën kundër trafikeve të paligjshme përmes detit.</p>		2014

Konsolidimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në drejtim të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurave të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar			
8.2	8.2.1 Ushtrimi i inspektiveve tematike dhe në bazë ankese në sistemin gjyqësor me qëllim monitorimin e respektimit të procedurave penale për realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, kryesisht të procedurave të ekstradimeve.	MD PP	Gjatë vitit
	8.2.2 Realizimi i trajnimeve me Shkollën e Magjistraturës dhe me organizata të tjera, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrativ të institucioneve që mbulojnë çështjet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.	Shkolla e Magjistraturës MD MPB PP	Gjatë vitit
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere të zbatimit të ligjit nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të operacioneve të përbashkëta kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme			
8.3	8.3.1. Rritja e bashkëpunimit me strukturat homologe të rajonit si me SELEC dhe Europol, me qëllim hartimin e materialeve analitike, vlerësimin e kërcënimeve, shkëmbimin e informacioneve dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta me përdorimin e formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.	MPB Policia e Shtetit	Dhjetor 2014

	<p>8.3.2. Zbatimi i objektivave të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Evropës Juglindore (Konventa e Vjenës) për bashkëpunimin ndërkufitar, grupet e përbashkëta të hetimit etj.</p> <p>8.3.3.1. Forcimi i bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Europol nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes Operacionale.</p> <p>8.3.3.2. Ratifikimi nga parlamenti i Marrëveshjes me Europolin.</p> <p>8.3.3.3. Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Europol-it në Policinë e Shtetit.</p> <p>8.3.3.4. Fillimi i shkëmbimit të të dhënave personale me Europol-in dhe informacioneve për krimin e organizuar.</p> <p>8.3.3.5. Shtrirja e aksesit të linjave të sigurta me Europol-in, platforma “SIENA” në Policinë e Shtetit.</p> <p>8.3.3.6. Rritja e numrit të operacioneve të përbashkëta policore me Europol-in.</p>	<p>Policia e Shtetit Prokuroria e Përgjithshme</p>	<p>Dhjetor 2014</p> <p>T1 2014</p> <p>Qershor 2015</p> <p>2014</p> <p>T1 2014</p> <p>Dhjetor 2014</p>
Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e hetimeve të përbashkëta			
8.4	8.4.1. Rritja me 5% e numrit të hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare kundër trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafiqeve të tjera të paligjshme.	Policia e Shtetit	2014
	8.4.2. Vazhdimi i zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për	Policia e Shtetit	Në vazhdimësi

mbrojtjen e dëshmitarëve, me qëllim riatdhesimin e dëshmitarëve të drejtësisë në vendet përkatëse dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me interes reciprok.	Prokuroria e Përgjithshme	
---	---------------------------	--

Prioriteti 5:

Të merren masa efikase për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi mbrojtjen e romëve dhe politikat antidiskriminim, si edhe të zbatohen të drejtat e pronësisë.

1. Të sigurohet zbatim efikas dhe rritje e ndërgjegjësimit publik për ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi			
Nr	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/ data
1.1	Rritja e numrit të rasteve të trajtuara nga KMD	KMD	Në vazhdim
1.2	<p>Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të stafit të KMD-së</p> <p>1.2.1 Trajnime të stafit të KMD në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).</p> <p>1.2.2 Manual për stafin e KMD-së për procedurat e shqyrtimit të rasteve të diskriminimit ndaj komunitetit rom/egjiptian, në kuadër të projektit SSIREC- UNDP.</p> <p>1.2.3 Dy ditë trajnim për çështjet e diskriminimit ndaj komunitetit rom/egjiptian, në kuadër të projektit SSIREC- UNDP.</p>	<p>KMD</p> <p>KMD</p> <p>UNDP në partneritet me KMD</p> <p>UNDP në partneritet me KMD</p>	<p>Në vazhdim</p> <p>Janar dhe në vazhdim 2014</p> <p>Realizuar</p> <p>Realizuar</p>
1.3	Forcimi i bashkëpunimit me institucionet homologe dhe partnerët kombëtarë (5 tryeza, vizita studimore etj).	KMD	Janar - dhjetor 2014

1.4	<p>Forcimi i bashkëpunimit me gjykatën</p> <p>1.4.1 Dhënia e opinioneve nga KMD për çështje diskriminimi.</p>	KMD	Në vazhdim
1.5	<p>Botimi i materialeve informuese:</p> <p>1.5.1 Botimi i broshurave informuese, fletëpalosjeve dhe manualeve mbi ligjin dhe mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi (6000 copë).</p> <p>1.5.2 Manual për OJF-të në kuadër të projektit “<i>Për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të diskriminuar</i>” të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në partneritet me KMD.</p> <p>1.5.3 Botimi i një përmbledhje të vendimeve të përkthyer të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Organeve të Barazisë .</p> <p>1.5.4 Përgatitja dhe shpërndarja e Broshurave Informuese “<i>Mbrojtja e minoriteteve në Shqipëri sipas ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”</i>”(1 000 copë).</p> <p>1.5.5 Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve informuese mbi ligjin “<i>Për mbrojtjen nga diskriminimi</i>” për komunitetin rom/egjiptian, në kuadër të projektit SSIREC- UNDP.</p>	<p>KMD</p> <p>KMD</p> <p>KSHH në partneritet me KMD</p> <p>KMD në partneritet me ODIHR</p> <p>KMD në partneritet me UNDP</p>	<p>Janar – Dhjetor 2014</p> <p>Realizuar</p> <p>Realizuar</p> <p>Realizuar</p> <p>Realizuar</p>

	<p>1.5.6 Botimi i një përmbledhje të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, opinione të bordit të ekspertëve dhe rekomandimeve legislative.</p> <p>1.5.7 Botimi i komentarit mbi ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.</p>	<p>KMD në partneritet me UNDP</p> <p>KMD me mbështetjen e UNDP</p>	<p>Realizuar</p> <p>Dhjetor 2014</p>
1.6	Realizimi i sondazheve, studimeve dhe raporteve të veçanta (4 copë)	KMD	Janar – dhjetor 2014
1.7	Monitorimi i punësimit në sektorin privat, me fokus aksesin e grupeve vulnerabël në punësim (1 fushatë monitorimi)	KMD	Tetor 2014
1.8	Zbatimi i rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (aktualisht Ministria e Arsimit dhe Sporteve) me shkresën Prot. 367, datë 1.7.2013 në lidhje me masat për eliminimin nga programet studimore të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, të literaturës që diskriminon dhe paragjykon të drejtat e komunitetit LGBT.	Ministria e Arsimit	Shtator 2014
1.9	<p>Rekomandime autoriteteve kompetente për ndryshimin e legjislacionit ekzistues në përputhje me ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”:</p> <p>1.9.1 Rekomandimet e KMD-së dërguar me letër</p>	KMD	Realizuar pjesërisht

	<p>zyrtare nr. Prot. 175, datë 7.3.2013 për ndryshime të 5 akteve; 2 rekomandime janë marrë plotësisht parasysh, njëri pjesërisht dhe dy të tjerë nuk janë marrë parasysh. KMD do t'i ridërgojë rekomandimet e papërfshira në Kodin Penal, si vijon:</p> <p>Rekomandimet e KMD-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të shtohet një dispozitë specifike në Kodin Penal me këtë përmbajtje: “Kërcënim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit” . – Të shtohet ose të riformulohet si vepër penale “Shpërndarja e materialeve raciste apo ksenofobe përmes sistemeve kompjuterike” në nenin 119/b “Fyerje dhe ksenofobi e motivuar nga racizmi në sisteme kompjuterike”, me qëllim që shpërndarja përmes sistemeve kompjuterike të materialeve fyese dhe homofobe mbi baza orientimi seksual dhe identiteti gjinor të personit, të përbëjë vepër penale. – Në ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2013, neni 265 u riformulua në mënyrë që grindjet dhe gjuha që nxit urrejtjen mbi baza të orientimit seksual të përbëjë vepër penale, duke lënë jashtë identitetin gjinor. Ne propozojmë që neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” të 		
--	--	--	--

	<p>riformulohet dhe nxitja e urrejtjes mbi baza “identiteti gjinor” të konsiderohet vepër penale.</p> <p>1.9.2 Rekomandimet e KMD-së dërguar me letër zyrtare nr. Prot. 360, datë 14.9.2012 Rekomandime për ndryshime në Kodin e Punës nuk janë pranuar. KMD do t’i ridërgojë ndryshimet e propozuara të Kodit të punës si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të riformulohet koncepti i “diskriminimit” në Kodin e Punës, duke shtuar bazat e diskriminimit, përfshi orientimin seksual dhe identitetin gjinor, sipas ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.– Të përfshihen edhe format e tjera të diskriminimit, si udhëzimi për diskriminim, ngacmimi seksual, viktimizimi dhe mosshoqërizimi si reagim i arsyeshëm.– Të parashikohet në Kodin e Punës detyrimi i punëdhënësit që të marra masat e duhura për sistemimin e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar; vendi i punës, në të gjitha elementet, duhet të përshtatet me natyrën e punës dhe nevojat e punëtorit, duke iu garantuar personave me aftësi të kufizuar të drejtën për punësim mbi baza barazie me personat e tjerë.		
--	--	--	--

	<p>1.9.3 Rekomandime për ndryshime në Kodin e Familjes</p> <p>KMD do të evidentojë dispozitat e Kodit të Familjes që mund të duhet të harmonizohen me ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ndryshimet e propozuara do t’ua dërgojë autoriteteve përkatëse.</p> <p>1.9.4 Rekomandime për ndryshime në Kodin e Procedurës Civile:</p> <p>Rekomandimet e KMD-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të riformulohet neni 12 për ta ndryshuar barrën e provës në procedime civile ku gjykata shqyrton një rast diskriminimi, në përputhje me kërkesat e direktivave të BE-së në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. – Të shtohet një paragraf pas paragrafit të parë të nenit 12 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me këtë përmbajtje: “Pasi paditësi paraqet provat mbi të cilat e bazon pretendimit dhe mbi bazën e të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri ka 		
--	--	--	--

	<p>detyrimit të vërtetojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.</p> <p>1.9.5 Rekomandime për ndryshime në Kodin Zgjedhor:</p> <p>Rekomandimet e KMD-së:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të riformulohet neni 3(3) i Kodit Zgjedhor, ku bazat për diskriminim të jenë në përputhje me dispozitat e nenit 1 të ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".– Të ndryshohet neni 67/6 i Kodit Zgjedhor nga “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini” në “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në çdo emra të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini”.– Neni 80(2) i Kodit Zgjedhor, pas fjalisë së parë të këtij paragrafi, të shtohet fjalia si vijon: “Radiotelevizioni publik e transmeton fushatën zgjedhore në formate dhe teknologji të aksesueshme, të përshtatshme për kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar.		
--	---	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - Të ndryshohet emërtimi i nenit 108 të Kodit Zgjedhor, nga “Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë”, në “Zgjedhësit me aftësi të kufizuar”. - T’i jepet prioritet zgjidhjes ligjore përmes rregullimeve specifike në Kodin Zgjedhor, me qëllim që t’iu garantohet e drejta e votës zgjedhësve që nuk mund të dalin nga shtëpia, duke iu mundësuar praninë në qendrat e votimit. - Të ashpërsohet gjoba e parashikuar në nenin 175(1) të Kodit Zgjedhor, si për zgjedhjet parlamentare edhe për ato vendore, si edhe të ngushtohet hendeku mes sanksioneve për zgjedhjet parlamentare dhe atyre për zgjedhjen e organeve vendore. 		
1.10	<p>Organizimi i trajnimeve me grupe të ndryshme profesionale për ligjin kundër diskriminimit.</p> <p>1.10.1 Trajnime për ligjin 10221/2010 “<i>Për mbrojtjen nga diskriminimi</i>” për gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë në 5 (pesë) rrethe.</p>	<p>KMD në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë</p> <p>KMD</p>	<p>Janar- dhjetor 2014</p> <p>Prill-shtator 2014</p>

	<p>1.10.2 Trajnime me dhomat e tregtisë.</p> <p>1.10.3 Trajnime për OJF-të.</p> <p>1.10.4 Trajnime për oficerët e policisë për ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përfshirja në një lëndë mbi barazinë dhe kundër diskriminimit në kurrikulumin edukativ të Qendrës për Formimin e Policisë së Shqipërisë (FPSH).</p>	<p>KMD, UN Women, Dhoma Kombëtare e Tregtisë</p> <p>KMD në partneritet me KSHH</p> <p>KMD me mbështetje nga PAMECA IV</p>	<p>Janar – maj 2014</p> <p>Janar – maj 2014</p> <p>Janar – maj 2014</p>
--	---	---	---

2. Krijimi dhe ndërgjegjësimi i opinionit publik për mbrojtjen nga diskriminimi dhe roli i KMD-së në këtë fushë

Nr.	Masat/aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Afati/data
2.1	<p>Arritja e një niveli bazë ndërgjegjësimi të publikut në përgjithësi</p> <p>2.1.1 Shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuere.</p> <p>2.1.2 Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Postën Shqiptare sh.a, do të shpërndahen materiale ndërgjegjësuere, kryesisht në zonat rurale.</p> <p>2.1.3 Organizimi i Ditëve të Hapura në rajone të ndryshme (5 Ditë të Hapura).</p> <p>2.1.4 Shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuere nëpërmjet biznesit privat dhe OJF-ve.</p>	<p>KMD</p> <p>KMD</p> <p>KMD në bashkëpunim me Postën Shqiptare sh.a</p> <p>KMD</p>	<p>Janar – dhjetor 2014</p> <p>Janar – dhjetor 2014</p> <p>Janar – dhjetor 2014</p>

		KMD	Janar – dhjetor 2014
2.2	Arritja e një niveli të lartë ndërgjegjësimi në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare.	KMD	Janar – dhjetor 2014
	2.2.1 Organizimi i takimeve informuese me stafet mësimore të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në Tiranë.	KMD	Janar – dhjetor 2014
	2.2.2 Leksione të hapura në universitete (4 aktivitete).	KMD	Janar – dhjetor 2014
2.3	Arritja e një niveli të lartë ndërgjegjësimi në fushën e punësimit në sektorin publik dhe privat.	KMD	
	2.3.1 Hartimi i një broshure informuese në fushën e punësimit në sektorin publik dhe privat.	KMD	Realizuar pjesërisht
	2.3.2 Shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuere.	KMD	Janar – dhjetor 2014
